



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja i) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe 19 paragrafi 1.9 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Strategjinë (shtetërore) për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2023, miratoi këtë;

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN 2023 - 2026 NË KOMUNËN E PODUJEVËS

Neni 1

Me këtë vendim miratohet Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 – 2026 në Komunën e Podujevës.

Neni 2

Plani komunal sipas nenit 1 të këtij vendimi, është i bazuar në Strategjinë shtetërore për avancimin e të drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e veprimit 2022-2024, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë fushën dhe veprimet e të drejtave të komuniteteve të cekura.

Neni 3

Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023 - 2026 në Komunën e Podujevës, është pjesë përbërëse e këtij vendimi.


Neni 4

Zbatimin e këtij vendimi, nën përkujdesjen e Kryetarit të Komunës e bëjnë organet kompetente të administratës së Komunës.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.Prot. 01-016/01-0055101/23
Podujevë, datë; 31 korrik 2023



Kryesuesi i Kuvendit
Ilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



PLANI
I VEPRIMIT PËR INTEGRIMIN E KOMUNITETEVE ROM, ASHKALI DHE EGJIPTIAN
NË KOMUNËN E PODUJEVËS 2023 - 2026

Podujevë, 31 korrik 2023

Shkurtesat

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) është mekanizmi me bazën më të detajuar ligjore të zhvilluar përmes bashkëpunimit ndërmjet organeve të nivelit qendror që kanë përgjegjësi të drejtëpërdrejtë, apo të tërthortë për çështjet e komuniteteve :

Bugjeti i Konsoliduar i Kosovës BKK

Kuvendi Komunal Podujevë KKP

Drejtoria Komunale e Arsimit DKA

Drejtoria e Administratës DA

Drejtoria e Shendetësisë dhe Mirëqenjes Sociale DSHMS

Drejtoria e Financave DF

Drejtoria për Planifikim dhe Zhvillim Ekonomik DPZHE

Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtje Hapsinor DPUMH

Drejtoria e Sherbimeve Publike DSHP

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport DKRS

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural DBPZHR

Drejtoria për Gjeodozi dhe Kadastër DGJK

Policia e Kosovës PK

Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës ZKM

Zyra për Komunitete dhe Kthim pranë Kryeministrit ZKK

Zyra për qeverisje të mirë, të drejta të njeriut, mundësi të barabarta dhe çështje gjinore ZQMTNJMBÇGJ

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK),

Ministria e Punës dhe Mirëqenjes Sociale (MPMS),

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor (MAPH),

Ministria e Integritimit Europian (MIE),

Ministria e Drejtësisë (MD),

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB),

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT),

Ministria e Administratës Publike (MAP),

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI)

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE),

Ministria e Financave (MF)

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS)

Ministria e Diasporës (MeD)

Policia e Kosovës (PK)

Qendra për Punë Sociale (QPS)

HYRJE

Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar në parimet e saj për një shoqëri demokratike, me të drejta të barabarta për të gjithë qytetarët pa dallim etnike, feje, gjuhe, gjinie, moshe në bazë të legjislacionit të saj primars Kushtetuta e Kosovës dhe atyre ndërkombëtare.

Qeveria e Kosovës shpreh përkushtimin dhe angazhimin e plotë në zbatimin e prioriteteve të **“Strategjisë dhe Planit të Veprimit të integrimit të komuniteteve rom, shkali dhe egjiptian 2022 – 2026”** të cilat në të njëjtën kohë paraqesin përgjigje ndaj kërkesave të procesit të Stabilizimit dhe Asociimit.

“Strategjia dhe Plani i Veprimit për integrim të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian 2022 – 2026” mbaron në vitin 2026, Prandaj Qeveria e Kosovës duke i kushtuar rëndësi të veçantë përmirësimit të pozitës së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në “Planin e dokumenteve strategjike të qeverisë për vitin 2022-2026” ka përfshirë edhe hartimin e planit të ri.

Për realizimin e Planit të Veprimit Komuna e Podujevës, përkatësisht Zyra për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim European OSCE, me pjesëmarrje të të gjitha drejtorive komunale, institucioneve të Sigurisë dhe Organizatave Joqeveritare që veprojnë në Podujevë ka hartuar Planin e ri të Veprimit 2023 – 2026.

Ky plan ruan strukturën organizative të Planit të Veprimit të Qeverisë së Kosovës, rrjedhimisht ky plan është hartuar duke u bazuar me planin qeveritar duke gërshetuar të dhënat dhe specifikat që ka komuna e Podujevës.

METODOLOGJIA

Pikënisja e hartimit të këtij plani ka qenë qasja e legjislacionit dhe e Qeverisë së Kosovës ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Synim kryesor i këtyre dokumenteve është integrimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare duke u mundësuar punësim, arsimim, vendbanime më të mira dhe qasje institucionale duke siguruar edhe mundësitë më të mira të pjesëmarrjes së tyre në vendim-marrje.

Sa i përket metodave dhe teknikave të përdorura për hartimin e planit, janë përdorur disa mënyra.

Përveç të dhënave të ofruara nga Strategjia dhe Plani i Veprimit i Qeverisë së Kosovës, janë përdorur edhe të dhëna nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Podujevës, janë praktikuar punë në grupe dhe hulumtime përmes pyetësorëve.

Fokus grupet kanë pasë qëllim nxjerrjen e nevojave imediate nga komunitetet duke ballafaquar mendimet e tyre. Kjo ka ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve nga përfaqësues të ndryshëm qeveritar dhe jo-qeveritar, Ndërsa pyetësorët kanë qenë të drejtuar ndaj institucioneve, përkatësisht drejtorive lidhur me planet dhe projektet që prekin komunitetet. Kjo ka ndihmuar në harmonizimin e veprimeve dhe ikjes së dyfishimit të punës.

Po ashtu, pyetësorë janë realizuar edhe me banorët e vendbanimeve rom, ashkali dhe egjiptian me qëllim të identifikimit të problemeve me të cilat ballafaqohen. Të gjitha njohuritë e marra nga terreni janë harmonizuar dhe janë listuar në aktivitete dhe hapa konkret.

Duke i vizituar vendbanimet ku jetojnë këto komunitete dhe intervistat që kemi bërë me shumë prej tyre, për të gjitha fushat. Ajo që ishte më kryesorja tek ata, dhe shihet si shqetësim i madh është papunësia, dhe si pasojë e kushteve të rënda ekonomike dhe si pasojë ka ardhë edhe deri tek fenomeni i migrimit ilegal me pretendim për një jetë më të mirë.

Fushat të cilat trajtohen në këtë plan të veprimit janë:

1. Arsimi

2. Shëndetësia

3. Punësimi, Mirëqenia Sociale;

4. Banimi, infrastruktura;

5. Mediat, kultura, rinia, sporti;

6. Diskriminimi

1. ARSIMI

Gjendja e arsimit të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në komunën e Podujevës nuk është në nivelin e duhur. Këtu përfshihen disa faktorë, problemet që ndikojnë në mosarsimim, braktisje të mësimin, sidomos nga gjinia femërore vazhdon të jetë problem i theksuar.

Nga anketat ku kanë marrë pjesë mbi **150 respondent**, të gjithë kanë përmendur gjendjen e rëndë ekonomike si faktori kryesor që ndikon në braktisje.

Për arsye të ndryshme siç janë gjendja e rëndë ekonomike, niveli jo i knaqshëm i vetëdijësimit mbi rëndësinë e arsimit, martesat e hershme dhe të paplanifikuara.

Shumë nxënës e ndërpresin shkollimin si pasojë e kushteve dhe rrethanave të lartëpërmendura.

Numri i nxënësve të cilët marrin pjesë në arsimin e mesëm dhe atë të lartë është shumë i ulët në krahasim me numrin e nxënësve të cilët e përfundojnë shkollën fillore.

Në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të Komunës së Podujevës në vitin 2022/2023 vijojnë mësimin 179 nxënës dhe 10 parashkollorë nga komunitetet RAE në këto shkolla

SHFMU “Shaban Shala” Podujevë, nga klasa –I- të deri –IX- të **08 nxënës**

SHFMU “Naim Frashëri” Podujevë, nga klasa –I- të deri –IX- të **78 nxënës**

SHFMU “Ibrahim Rugova” Podujevë, nga klasa –I- të deri –IX- të **72 nxënës**

SHFMU “Enver Maloku” Podujevë, nga klasa –I- të deri –IX- të **0 nxënës**

SHFMU “Luigj Gurakuqi” Batllavë, nga klasa –I- të deri –IX- të **8 nxënës**

SHFMU “Zahir Pajaziti” Orllan, nga klasa –I- të deri –IX- të **8 nxënës**

SHFMU “Ali Ajeti” Sfeqël, nga klasa –I- të deri –IX- të **5 nxënës**

SHFMU “Kongresi i Manastirit” Gllamnik, nga klasa –I- të deri –IX- të **0 nxënës**

Gjithësejt në SHFMU janë 179 nxënës të komuniteteve jo-shumicë.

Ndërsa në shkollat e mesme të lartë e vijojnë mësimin **16 nxënës** në këto shkolla :

SHML “Isa Boletini” Podujevë, **14 nxënës**

SHML “Fan S. Noli” Podujevë, **2 nxënës**

SHML “ Zahir Pajaziti” Orllan, **0 nxënës**

SHML “ Aleksandër Xhuvani” Podujevë, **0 nxënës**

Gjithësejt në shkollat fillore dhe të mesme të larta e vijojnë mësimin **195 nxënës** të komuniteteve jo-shumicë.

Në universitet shkollimet i vijnë gjithsej **3 student** nga komunitetet RAE.

Sistemi i Arsimit është unik dhe ofron mundësi të barabarta shkollimi për të gjithë fëmijët e moshës shkollore, pa asnjë dallim, qoftë etnik, fetar apo gjinor.

Në komunën e Podujevës mësimi organizohet vetëm në gjuhën shqipe, për faktin se nxënësit e komuniteteve flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe, ata mësojnë së bashku në klasë me nxënësit e shumicës.

Duke parë gjendjen e rëndë socio-ekonomike të komuniteteve jo-shumicë, nevojiten programe të veçanta për stimulimin e arsimit qoftë përmes bursave, OJQ-ve vendore dhe ndërkombëtare dhe donatorëve tjerë që **të ndahen bursa** për nxënës dhe studentë të cilët sado pak do t'i mbulojnë shpenzimet e tyre për vijimin e mësimin më cilësor.

2. SHËNDETËSIA

Infrastruktura dhe rrjeti i shërbimeve shëndetësore në Komunën e Podujevës është i kënaqshëm dhe ka këtë infrastrukturë:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF)

Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) Orllan

Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) Lluzhan

Qendra e Mjekësisë Familjare (QMF) Kërpimëh, dhe poashtu ka 18 Ambulanca të Mjekësisë Familjare (AMF)

Ndërtimi i Ambulancës Specialistike afër SHFMU "Enver Maloku" Podujevë dhe

Ndërtimi i Objektivit të Ri të Emergjencës te Besiana – Podujevë.

Shërbimet mjekësore janë në nivel për të gjithë qytetarët pa dallime.

Ku ka edhe aktivitete dhe trajtime shëndetësore të sistemit primar ndaj komuniteteve dhe janë në nivel të duhur.

Aktivitetet e ofrimit të kujdesit parësor për nënat dhe fëmijët nuk mungojnë, veprimet zbatohen nga QKMF, materniteti dhe këshillimorja për nëna dhe fëmijë dhe këshillimorja për planifikim familjarë dhe kontrceptiv.

Në vazhdimësi është punuar në këtë drejtim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore në kujdesin primar, në imunitet, në trajtimin e sëmundjeve dhe në parandalimin e anemive dhe infeksioneve, parazitëve të zorrëve dhe sëmundjeve tjera.

Në këtë drejtim është punuar sistematikisht në edukimin shëndetësorë në grupe dhe bashkësi, si dhe në sigurimin e kushteve dhe praktikave tjera në kontekst të ruajtjes së shëndetit dhe qasjet e ekipeve mjekësore ndaj komuniteteve gjithëherë kanë qenë në nivel.

Është punuar në vazhdimësi në trajnimin dhe përgatitjen rreth plasimit të njohurive rreth higjenës personale dhe kolektive, të ushqyerit higjenik dhe ruajtjes së ushqimit.

Në mënyrë permanente nga ana e shërbimit epidemiologjik është bërë kontrolli i ujit të pijshëm dhe marrja e masave në parandalimin e ndotjes së ajrit dhe ambientit për të gjithë qytetarët.

Këto probleme me ujin e pijes i kanë banorët në fshatin Orllan, të cilët nuk kanë rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit, ky është problem i të gjithë banorëve atje, të cilët furnizimin me ujë e bëjnë nga burimet natyrore, prej bazenave dhe puseve me ramje të lirë. Në të ardhmën kërkohet zgjidhje për këtë problem.

3. PUNËSIMI DHE MIRËQENIA SOCIALE

Papunësia tek komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian është problem kryesor, i cili është theksuar nga të gjithë të anketuarit në Komunën e Podujevës, për këtë arsye edhe shumë prej tyre kanë migruar jashtë Kosovës drejt vendeve perëndimore, duke e parë këtë si mundësi për një jetë më të mirë.

Të punësuarit në këto komunitete numri është simbolik në sektorin publik dhe atë privat, të punësuar janë **27 persona**. Në FSK – **3 persona** në KEC – **1 person**, në Policinë e Kosovës – **2 persona**, në Arsim – **4 persona**, në Shërbimin e Zjarrëfiksëve – **1 person**, në Shëndetësi – **1 person**, në Kompaninë “Pastrimi” – **7 punëtorë** dhe në Komunë – **1 person**, në Kosovatrans – **3 persona**, punëtorë teknik në shkollë – **2 persona**, në MBPZHR – **një person** dhe në RTK – **një person**.

Në Entin e Punësimit – Zyra për punësim për vitin 2022/2023 janë evidentuar si të pa punë **31 persona** të komuniteteve RAE, ky numër nuk është real pasi ka informata se një numër i konsiderueshëm i të papunëve nuk janë të lajmëruar.

Të papunët duhet të lajmërohen çdo tre muaj për ta patur gjendjen reale ekzistuese.

Në Komunën e Podujevës, kontribut të veçantë përveç organizatave ndërkombëtare, japin edhe OJQ –të vendore të komuniteteve RAE që merren me integrimin e tyre.

OJQ –të e komuniteteve RAE siç janë “**Shpresa Demokratike**”, “**Qendrimi**” dhe “**Një hap me ne**”

Realizojnë aktivitete të ndryshme ku i trajnojnë pjestarët e komuniteteve me trajnime për zanate të ndryshme. Si dhe i ndihmojnë ata dhe i pajisin me mjete për t'i ushtruar ato zanate për të cilat janë trajnuar. Trajnime ofrohen edhe për pjesëtarët femra të komuniteteve ku ofrohen trajnime përkatëse si: për frizere, rrobaqepëse etj. **Komuna** në bazë të **Memorandumit të Mirëkuptimit dhe Bashkëpunimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM)** po vazhdon me implementimin e projektit për Stabilizimin e Komuniteteve jo-shumicë, projekte të cilat financohen nga BE dhe menaxhohen nga Zyra e BE-së në Kosovë në bashkëfinancim me Komunën për projekte publike, arsimore, po ashtu edhe me projekte tjera individuale për komunitetet jo-shumicë për vetëpunësim dhe rigjenerim të të hyrave me mjete pune me participim.

Rekomandojmë që të ndërmerren masa nga komuna për zhvillimin e projekteve për aftësimin profesional të pjesëtarëve nga komunitetet jo-shumicë në fushat dhe profesionet që ka nevojë tregu i punës.

Në bazë të evidencës nga Qendra për Punë Sociale janë të evidentuara **66 familje të komunitetit ashkali me 353 anëtarë dhe 5 familje të komunitetit rom me 37 anëtarë.**

Gjithësejt **71 familje me 390 antarë të komuniteteve jo-shumicë.**

Konsiderojmë që është e nevojshme ndërmarrja e veprimeve me qëllim të përmirësimit të gjendjes dhe ofrimit të ndihmës në forma të ndryshme edhe për familjet me gjendje të rëndë, por që nuk janë të përfshirë në asistencë social.

4. BANIMI DHE INFRASTRUKTURA

Komunitetet pakicë jetojnë bashkarishtë me shumicën në komunën e Podujevës, si në qytet po ashtu edhe në pjesët rurale.

Në qytet jetojnë në këto lagje:

Lagjja "Ali Ajeti" **71 shtëpi me 388 banorë të Komunitetit Ashkali, 9 shtëpi të Komunitetit Rom me 67 anëtarë dhe 2 shtëpi të Komunitetit Egjiptian me 11 anëtarë.**

Lagjja rr. "Xhafer Meta" **51 shtëpi me 318 banorë** të Komunitetit Ashkali.

Fshati Orllan **7 shtëpi 44 banorë** të Komunitetit Ashkali.

Fshati Batllavë **13 shtëpi me 63 banorë** të Komunitetit Ashkali.

Fshati Sfeçël **3 shtëpi me 12 banorë** të Komunitetit Ashkali.

Fshati Peran **3 shtëpi me 11 banorë** të Komunitetit Ashkali.

Te hekurudha është **1 familje me 7 anëtarë** të Komunitetit Ashkali.

Afër QKMF së është një familje me **7 anëtarë** të Komunitetit Ashkali.

Në banesa janë 2 familje me 9 anëtarë të Komunitetit Ashkali.

Në Lagjen e Kuvajtit në Balloc **1 familje me 5 anëtarë** të Komunitetit Ashkali.

152 shtëpi të komunitetit ashkali me **857 banorë.**

09 shtëpi të komunitetit rom me **67 anëtarë** dhe

02 shtëpi të komunitetit Egjiptian me 11 anëtarë.

Gjithësejt janë 163 familje me 935 anëtarë.

Infrastruktura është e rregulluar mirë, me rrugë, trotuare, rrjet të kanalizimit, rrjet të ujësjellesit, në qytet rrjeti i ndriqimit dhe shërbimet tjera në përgjithësi.

Ka pasur kërkesë për këto projekte si në vijim:

- 1. Projekti i rrugicës “Sami Rama” në lagjen “Xhafer Meta”,**
- 2. Projekti i trotuarit në Batllavë, rruga “Enver Maloku”, lagjja e Ashkalive,**
- 3. Ndërtimi i Rrjetit të Ri të Ujësjellesit në lagjen “Ali Ajeti”, rruga “Ulqini” dhe**
- 4. Ndërtimi i Rrjetit të Ndriqimit rruga e parë, lagjja “Ali Ajeti”, Podujevë, banojnë komuniteti rom dhe ashkali.**
- Rruga “Skënderbeu” është në ndërtim e sipër, projekt me rëndësi të veçantë për të gjithë banorët, ku do të ndikojë në sigurinë e qytetarëve në komunikacion edhe tek komunitetet jo-shumicë tek nxënësit dhe banorët e këtyre komuniteteve në periudhë afatgjatë.
*Zgjerimi i rrugës, trotuarët, ndriqimi, shtigjet e biciklistave dhe rrjetet tjera përcjellëse.
- 6. Projekte shumë të rëndësishme në ndërtim e sipër, janë edhe për fshatin Orllan. Rrjeti i Ujësjellesit dhe kanalizimit për të gjithë banorët ku jeton edhe komuniteti Ashkali.**

Projektet e tilla do të vazhdojnë edhe në të ardhmen si në arsim, infrastrukturë, banim, ambient dhe fusha të tjera.

Janë edhe disa kërkesa tjera që kanë shumë nevojë për ndërtim të shtëpive, ku janë në gjendje shumë të rëndë socio-ekonomike. Prej tyre disa familje që kanë bërë kërkesë nuk kanë pronë të vetën.

Disa familjeve u janë ndërtuar shtëpitë, qoftë nga komuna po ashtu nga Zyra për Qeverisje të Mirë pranë Kryeministrisë, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe donatorë të ndryshëm, kërkesat për shtëpi janë të mëdha dhe çdo herë duhet kërkuar mundësi për ndërtim të shtëpive për familjet në nevojë.

Pasi nuk kanë hapësirë, troje, për ndërtime të shtëpive, ka shumë kërkesa në të gjitha lagjet ku jetojnë, komunitetet jo shumicë për renovimin e shtëpive ekzistuese, renovim të brendshëm apo të jashtëm të shtëpisë.

Po ashtu ka kërkesa edhe për mbindërtim në ato shtëpia ku ka mundësi ndërtimi si rezultat i mungesës së hapësirës të mjaftueshme për të banuar në një shtëpi me shumë anëtarë.

Po ashtu duhet të shikohet mundësia e gjetjes së një prone ku do të kishin mundësi të ndërtojnë shtëpi familjet të cilat kanë kushtet e vështira dhe nuk kanë pronë në emër të tyre.

Po ashtu duhet shikohet mundësia e gjetjes së një prone ku do të kishin mundësi të ndërtojnë shtëpi familjet të cilat kanë kushtet e vështira dhe nuk kanë pronë në emër të tyre.

Të krijohen lehtësira nga Komuna e Podujevës për legalizim të pronave për familjet që jetojnë në vendbanime informale në ato raste kur prona nuk është në emër të tyre.

Në komunën tonë nuk ka banim kolektiv për raste sociale, këtu kemi të bëjmë vetëm me raste strehim – banim individual për raste shumë të rënda socio-ekonomike.

Shpresoj të zgjidhet çështja e pronave për zgjidhjen e situatës së banimit për ato familje që janë me gjendje të rëndë ekonomike.

5. MEDIAT, KULTURA, RINIA, SPORTI

Mediat lokale luajnë rol të rëndësishëm për komunitetin RAE, dhe për informimin e tyre për të gjitha fushat e jetës. Komunitetet çdo herë informohen për të marrë pjesë në të gjitha debatet publike me qytetarë ku mund të debatojnë dhe t'i shprehin kërkesat e tyre.

Shpërndarja e informacionit për të gjitha aktivitetet publike bëhet përmes TV Llapit dhe radiove lokale – Radio Llapi dhe Radio Vizioni dhe mjeteve tjera të informimit.

Po ashtu vlenë të përmendet se në **“Radio Vizioni”** është një program një herë në javë i komunitetit Ashkali, aty ka debate, informacione, urime dhe përshendetje, programe muzikore etj.

Vlen të theksohet si nevojë mungesa e kampanjave vetëdijësuese, qoftë përmes TV Llapit dhe radiove lokale, ose edhe të rrjeteve sociale mbi informimin e komuniteteve pakicë, me theks të veçantë për të rinjtë e komuniteteve mbi pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe në të gjitha proceset vendim-marrëse në Komunën e Podujevës.

Këto aktivitete do të realizoheshin në bashkëpunim me organizata dhe mekanizma të cilët realizojnë programe për integrimin e komuniteteve në shoqëri.

KULTURA, RINIA, SPORTI

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive është i kufizuar si pasojë e mungesës së e infrastrukturës dhe mjeteve financiare, për t'i menjanuar sadopak këto është e nevojshme të vazhdohet dhe të rritet mbështetja për klubet kulturore dhe sportive.

Të mundësohet realizimi i ushtrimeve për klubet sportive në palestrën e sportit “Hakif Zejnullahu” Podujevë

Të ketë emisione të veçanta në radiot lokale për aktivitetet kulturore dhe sportive që i'u kushtohen komuniteteve pakicë.

Përkrahja e aktiviteteve rinore po ashtu është e një rëndësie të veçantë.

Në këtë kontekst DKRS duhet të punojë në bashkëpunim me OJQ-të lokale dhe të realizojnë bashkarishtë aktivitete kulturore dhe artistike me pjesëmarrje të të rinjëve për ditët e festive të cilat parashihen në bazë të Ligjit për festat zyrtare, përkatësisht festimin e 8 prillit që është Dita e Romëve dhe 15 shkurtit Ditës së Ashkalinjëve.

Në Podujevë të gjitha klubet janë të hapura për të gjithë ata që kanë talent në sportet si në futboll, basketboll, volejball, hendboll, not, karate etj.

6. DISKRIMINIMI

Diskriminimi në bazë të etnisë për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në bazë të Strategjisë për Arritjen e Objek-

tivave, parasheh zhvillimin dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave, programeve dhe projekteve, ku do të ndikojnë në luftimin e racizmit dhe diskriminimit ndaj Komuniteteve Rom, Ashkal dhe Egjiptian në mënyrë sistematike dhe në rritjen e cilësisë së jetës për komunitete jo-shumicë, si në arsim, punësim, mirëqenie sociale, shëndetësi, banim, strehim, infrastrukturë dhe të gjitha sferat tjera të jetës.

Që ndikojnë në mënyrë sistematike përmes Zhvillimit Ekonomik dhe zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse në të gjitha fazat dhe nivelet e politikave dhe programeve për mirëqenie sa më të mire për të gjithë qytetarët e sidomos për banorët e Komuniteteve jo-shumicë në Komunën tonë.

*Diskriminimi dhe Siguria Njerëzore

* Një ndër qëllimet kryesore të sigurisë njerëzore është ofrimi i kushteve të gjithë njerëzve për shfrytëzimin dhe zgjerimin e mundësive, zgjedhjeve dhe aftësive të tyre, duke qenë të lire nga pasiguria.

* Diskriminimi i bazuar në çfarëdo baze, pengon njerëzit që në mënyrë të barabartë të ushtrojë të drejtat dhe zgjedhjet e tyre dhe kjo rezulton jo vetëm në pasiguri ekonomike dhe shoqërore, por gjithashtu prek edhe vetërespektin dhe vetëvendosjen e personit të diskriminuar, gjithashtu diskriminimi racor dhe shkelja e të drejtave të anëtarëve të grupeve të nënshtruara të minoriteteve, paraqet jo stabilitet shoqëror.

* Njohja e dinjitetit të lindur dhe të drejtave të barabarta, ashtu siç është deklaruar në Preambulën e Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, të gjithë pjesëtarëve të familjes njerëzore, paraqet shtyllën për liri, drejtësi dhe paqe në botë.

* Prandaj, tejkalimi de facto i pabarazive të bazuara në race, gjini, identitet kombëtar, religjion, gjuhë dhe kushtet të tjera sociale, ekonomike, duhet të jenë prioritetet të larta në agjendën e sigurisë njerëzore.

* Në përgjithësi, diskriminimi konsiderohet çdo formë e dallimit, përjashtimit, kufizimit ose ndonjë preferim, me qëllim të mohimit ose refuzimit të të drejtave të barabarta dhe mbrojtjes, si dhe paraqet mohim të parimit të barazisë ndaj dinjitetit njerëzor.

* Varësisht nga arsyeja për trajtim të tillë, ne mund të flasim për diskriminimin në baza racore, kombëtare, ngjyre, gjinie, religjioni etj.

* Është shumë e rëndësishme të dihet se nuk mund të konsiderohet çfarëdo dallimi menjëherë edhe si diskriminim në kuptimin e abuzimit të të drejtave të njeriut.

Përderisa ky dallim është i bazuar në kritere të arsyeshme dhe objektive, ai mund të justifikohet.

*Njihet edhe diskriminimi pozitiv, ose ndryshe quhet veprim pozitiv, që është praktikuar nga institucionet qeverisëse të Komunës së Podujevës për Komunitetet pakicë.

* Masat e veprimeve pozitive kanë qenë çdoherë të përkrahura, për favorizimin e komuniteteve jo-shumicë me qëllim të kompenzimit të pabarazive të mëhershme për integrimin e tyre në të gjitha fushat e jetës dhe për një stabilizim socio-ekonomik, dhe për mbrojtjen nga diskriminimi dhe të drejtat e tyre për të gjithë qytetarët.

* Në kuadër të institucioneve të Komunës është edhe zyrtarja përgjegjëse për mbrojtjen nga diskriminimi.

PLANI I ZBATIMIT

| I. Arsimi | | | | |
|--|--|-------------|----------|---------------|
| Qëllimi: Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që i kontribuon integritet të plotë të komuniteteve Rom, Ashaklinjë dhe Egjiptian në shoqëri. | | | | |
| Objektivi 1: Përmirësim i dukshëm i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve RAE | | | | |
| Aktiviteti 1: Përfshirja e edukatorëve Rom, Ashaklinjë dhe Egjiptian. Dhe asistentëve të tyre në nivelin | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 1.1 Hulmtimi i nevojave për arsimimin parafillor dhe parashkollor dhe krijimi i kushteve për pjesëmarrje | 2023 | DKA,ZKKK | BKK, donatorë |
| 2 | Veprimi 1.2 Identifikohen edukator të kualifikuar dhe asistentet nga radhet e komuniteteve RAE | 2023 | DKA,ZKKK | BKK |
| 3 | Veprimi 1.3 Kycja në sistemin arsimor të personelit të identifikuar | 2023 | DKA,ZKKK | BKK |
| 4 | Veprimi 1.4 Publikimi i raportit hulmtues | 2023 | DKA,ZKKK | BKK |
| Aktiviteti 2: Ofrimi i programeve ri-integruese për fëmijët e kthyer nga diaspora | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 2.1 Identifikohen familjet e kthyer nga jashtë | Vazhdimisht | ZKKK,DKA | BKK |
| 2 | Veprimi 2.2 Ofrohen kurse gjashtëmujore për gjuhën e vendit | Vazhdimisht | ZKKK,DKA | BKK |
| 3 | Veprimi 2.3 Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas për nxënës | Vazhdimisht | ZKKK,DKA | BKK |

Plani i Veprimit

| | | | | |
|---|---|-------------|----------|-----|
| 4 | Veprimi 2.4 Nostrifikohen dokumentacionet shkollore | Vazhdimisht | ZKKK,DKA | BKK |
| 5 | Veprimi 2.5 Publikimi I të dhënave mbi nxënësit e riintegruar në shkolla , kurset e mbajura , tesktes shkollore të shpërndara | Vazhdimisht | ZKKK,DKA | BKK |

Shënim: BKK-Buxheti i konsoliduar i Kosovës, Për këto veprime ndahen fonde nga MASHT-i

| Aktiviteti 3: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim | | Periudha | Bartës | Buxheti |
|--|--|-------------|----------|---------|
| 1 | Veprimi 3.1 Organizmi I fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë | 2023 -2026 | ZKKK-DKA | BKK |
| 2 | Veprimi 3.2 Identifikohen nevojat e nxënësve që nuk vijojnë mësimin me rregull | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | BKK |
| 3 | Veprimi 3.3 Ofrohen programe mësimi joformale intensive për nxënësit që kanë braktisur shkollën në nivelin fillor dhe të mesëm | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | BKK |
| 4 | Veprimi 3.4 Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | BKK |
| 5 | Veprimi 3.5 Ofrohen orë plotësuese në shkollat për gjuhë rome dhe lëndë tjera të nevojshme nëse ka. | Vazhdimisht | DKA | BKK |
| 6 | Veprimi 3.6 Caktohen mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me vështirësi në të nxënë përkatësisht në orë plotësuese | 2023 | | |

| Aktiviteti 4. Krijimi I kushteve për vazhdimin e arsimit pas shkollimit të obligueshëm | | Periudha | Bartës | Buxheti |
|---|---|-----------|--------------|---------|
| 1 | Veprimi 4.1 Themelimi i fondit për bursa | 2023 | DKA | BKK |
| 2 | Veprimi 4.2 Themelimi i komisionit të përbashkët të përbërë prej komunitetve, institucioneve dhe organizatave për ndarjen e bursave | 2023 | DKA-ZKKK-OJQ | BKK |
| 3 | Veprimi 4.3 Organizohen fushata ndërgjegjësimi për vazhdimin e shkollimit | 2023-2026 | DKA-ZKKK-OJQ | BKK |
| 4 | Veprimi 4.4 Ofrohen kurse përgatitore gjatë vitit shkollor për regjistrim në shkollën e lartë, për nxënësit me rezultate të dobëta | 2023-2026 | DKA-ZKKK | BKK |

Plani i Veprimit

| Aktiviteti 5. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor | | | | |
|---|---|----------------------|----------|---------|
| | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 5.1 Identifikohen fëmijët me nevoja të veçanta | 2023 dhe vazhdimisht | ZKKK-DKA | BKK |
| 2 | Veprimi 5.2 Raportimi dhe koordinimi i punës me MASHT-in për veprimet e mëtutjeshme | Vazhdimisht | DKA | BKK |

| Aktiviteti 6. Parandalimi i sergregacionit dhe diskriminimit me akte ligjore | | | | |
|--|--|-------------|-----------|---------|
| | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 6. Raportimi i shkollave për rastet e raportuara të sergregacionit ose anashkalimit | Vazhdimisht | DKA | BKK |
| 2 | Veprimi 6.2 Adresim dhe zgjedhje e rasteve të raportuara | Vazhdimisht | DKA | BKK |
| 3 | Veprimi 6.3 Në bashkëpunim me MASHT-in, ofrohen trajnime për mësime për mënjanimin e paragjyqimeve | Vazhdimisht | DKA-MASHT | BKK |

| Objektivi 2: Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe organizata relevante në funksion të arsimit të pjestarëve të komunitetev Rom , Ashkali dhe Egjiptian | | | | |
|---|--|---------------------|-------------|---------|
| Aktiviteti 1: Aktivitete të përbashkëta me policinë e komunitetit lidhur me sigurinë | | | | |
| | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 1.1 Bashkëpunim me Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi. | 2023-2026 | DKA-ZKKK | BKK |
| 2 | Veprimi 1.2. KKSb identifikon rastet që kanë të bëjnë me cenimin e sigurisë së nxënësve në shkolla | Vazhdimisht | DKA | BKK |
| 3 | Veprimi 1.3 DKA lidh marrëveshje bashkëpunimi me policinë e komunitetit lidhur me ofrimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Element të marrëveshjes janë patrullimi i rregullt, në afërsi të shkollave. | 2023 Vazhdimisht | DKA-PK | BKK |
| 4 | Veprimi 1.4 DKA, shkollat dhe policia e Kosovës hartojnë planin e veprimit | 2023-2026 | DKA-PK | BKK |
| 5 | Veprimi 1.5 Mbahen takime të rregullta tremujore në mes DKA-shkollave , PK dhe përfaqësuesve të komuniteteve. | Vazhdimisht | DKA-ZKKK-PK | BKK |
| 6 | Veprimi 1.6 Hartohen dhe publikohen raportet tremujore | Vazhdimisht | DKA-PK | BKK |

Plani i Veprimit

| Aktiviteti 2. Masat për mosrespektim të Ligjit mbi shkollimin e obliguar | | | | |
|--|---|-------------|----------|---------|
| | | Periodha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 2.1 Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijnë në shkollën rregullisht | vazhdimisht | DKA-ZKKK | BKK |
| 2 | Veprimi 2.2 Organizohen takime informative me komunitete në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar | 2023-2026 | DKA-ZKKK | BKK |
| 3 | Veprimi 2.3 Ndërmerren masa ligjore ndaj stafit të shkollës që nuk raporton me kohë rastet e braktisjes dhe mosvijueshmërisë. | vazhdimisht | DKA | BKK |

| Aktiviteti 3: Ofrohen programe ekzistuese për zvogëlimin e shkollës së analfabetizimit - përkrahje | | | | |
|--|--|----------|----------|---------|
| | | Periodha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 3.1 Identifikohen partnerët që ofrojnë programe të licensuara kundër analfabetizimit | 2023 | DKA-ZKKK | |
| 2 | Veprimi 3.2 Identifikohen individët që nuk kanë vijuar shkollën | 2023 | DKA-ZKKK | |
| 3 | Veprimi 3.3 Organizohen takime me grupet e identifikuar me qëllim të informimit për mundësitë lidhur me zhdukjen e analfabetizimit | 2023 | DKA-ZKKK | |
| 4 | Veprimi 3.4 Në kuadër të qendrave të komunitetit të organizohen kurse vetëm për femra | 2023 | DKA-ZKKK | |

| Aktiviteti 4: Krijimi i qendrës burimore në nivel komunal | | | | |
|---|--|-------------|-----------------|---------|
| | | Periodha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 4.1 Ofrohen orë plotësuese për nxënësit e shkollave fillore | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | |
| 2 | Veprimi 4.2 Kurse të ndryshme për pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkalinje dhe egjiptian | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | |
| 3 | Veprimi 4.3 Ofrojnë programe për zhdukjen e analfabetizimit | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | |
| 4 | Veprimi 4.4 Përfshirja e prindërve në aktivitete të Qendrës. | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | |
| 5 | Veprimi 4.5 Krijimi i këshillit të prindërve të nxënësve nga radhët e komuniteteve rom, ashkalinje dhe egjiptian | Vazhdimisht | DKA-ZKKK | |
| 6 | Veprimi 4.6 ZKKK lehtëson koordinimin e punëve të KPNRAE me KPA | Vazhdimisht | DKA-ZKKK KPA | |

Plani i Veprimit

Këshilli i prindërve të Nxënësve të Komuniteteve ROM, Ashkali dhe Egjiptian

Këshilli i prindërve dhe arsimtarëve

| Aktiviteti 5: Organizohen aktivitete kulturore sportive | | | | |
|---|--|--|----------------------------------|--------------|
| | | Periudha | Bartës | Buxheti |
| 1 | Veprimi 5.1 Formohet grupi kulturor i shkollës në përbërje të mësimeve të mesimdhënësve , nxënësve dhe prindërve | | DKA-shkolla ZKKK | Nuk kërkohen |
| 2 | Veprimi 5.2 Formohen grupet sportive në shkollë në formë të klubeve sportive | 2023 | DKA-shkolla ZKKK | Nuk kërkohen |
| 3 | Veprimi 5.3 Hartohet plani shkollor për aktivitete kulturore dhe sportive me karakter multi-etnik | 2023 | DKA-shkolla grupet e formuara | Nuk kërkohen |
| 4 | Veprimi 5.4 Caktohen përgjegjësit për realizimin e aktiviteteve sipas planit të hartuar | | DKA-shkolla grupet e formuara | |
| 5 | Veprimi 5.5 Caktohet buxheti për aktivitete e parapara në planin e hartuar | | DKA-shkolla grupet e formuara | |
| 6 | Veprimi 5.6 Organizohen aktivitetet kulturore në përputhje me interesat e komunitetit | vazhdimisht në bazë të planit të hartuar | DKA-shkolla grupet e formuara | DKRS, DKA |

| SHËNDETËSIA | | | | |
|---|---|-------------|-------------------------|---------|
| Qëllimi: Përmirësimi i statusit shëndetësor dhe social, dhe cilësisë së shërbimit dhe qasjes ndaj sistemit shëndetësor dhe social të Kosovës, pa diskriminim të tri komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. | | | | |
| Objektivi 1: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjeno-sanitare dhe mjedis i përshtatshëm dhe i shëndetshëm në vendbanimet e komuniteteve RAE | | | | |
